




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 10.4 dhe nenit 52.2 shkronja a), të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 10.06.2010, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 09.07.2010, miraton këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E RREGULLORËS PËR ORGANIZIMIN DHE
BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE
LAGJET URBANE TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim aprohet Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Gjilanit.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Gjilanit

III

Zbatimin e këtij vendimi e bëjnë të gjitha organet e administratës komunale, ndërsa për implementimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit

01.Nr. 8356
Gjilan, më 09.07.2010

Kuvendi i komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues